



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

KRYETAR

Nr. 14214 prot

Vlorë, më 15.07 2026

PROJEKTVENDIM

“PËR

“MIRATIMIN E RREGULLORES SË SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS
PUBLIKE NË BASHKINË E VLORËS”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 224, datë 01.04.2026, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”, si dhe në Urdhërin e Brendshëm nr. 869, datë 11.06.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për implementimin e VKM-së nr. 224, datë 01.04.2026, “Për miratimin e rregullores së hapësirave publike”, si dhe relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Vlorë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës __. __.2026:

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr. 39 datë 30.04.2024, i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirës publike në territorin e Bashkisë Vlorë”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Urbanistikës, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Policia Bashkiake, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.


KRYETAR
Brunilda Mersini



PUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 14214 prot

Vlorë, më 1507 2026

RELACION

**“PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË SHFRYTËZIMIT TË HAPËSIRËS PUBLIKE
NË BASHKINË VLORË”**

Bashkia Vlorë është angazhuar në përgatitjen e këtij projektvendimi në përputhje me fushën e përgjegjësisë, veprimtarisë, kompetencave dhe rolit të saj rregullator në administrim dhe menaxhimin e hapësirave publike për hapësirat publike në administrim dhe menaxhimin e hapësirave publike.

Bashkia Vlorë është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të saj për planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj në mbështetje të pikës 14, nenit 23, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Bazuar në ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, në zbatim të ligjit të vendimit nr. 224, datë 01.04.2026, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregulloreve të shfrytëzimit të hapësirës publike” Bashkia Vlorë ka hartuar projektvendimin e shfrytëzimit të hapësirave publike në territorin në juridiksion të saj.

Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e rregulloreve të shfrytëzimit të hapësirës publike në Bashkinë Vlorë, me synim përcaktimin e rregullave, kushteve, kritereve dhe procedurave të hollësishme për përdorimin e hapësirave publike në territorin e juridiksionit të saj.

Gjithashtu, qëllimi i kësaj rregulloreje është edhe garantimi i një përdorimi të rregullt funksional dhe të qëndrueshëm të hapësirës publike, në përputhje me interesin publik, sigurinë, estetikën urbane dhe mbrojtjen e mjedisit, si edhe synimi për të siguruar parime të qarta për përgjegjësitë e strukturave të Bashkisë Vlorë dhe përdoruesve të hapësirës publike, si dhe të garantojë transparencën, barazinë e trajtimit dhe paanësinë në procesin e shqyrtimit, dhënies së lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike.

Ky projektvendim është në përputhje me politikat e Bashkisë Vlorë për përmirësimin e menaxhimit të territorit, zhvillimin urban të qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e cilësisë së hapësirave publike.

Miratimi i kësaj rregulloreje kontribuon në konsolidimin e kuadrit rregullator për administrimin e hapësirave publike, duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë të rregullt, transparente dhe në funksion të interesit publik.

Në kushtet ku, administrimi dhe përdorimi i hapësirave publike përbën një aspekt të rëndësishëm të menaxhimit të territorit dhe të ushtrimit të funksioneve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, miratimi i vendimit nr. 224, datë 01.04.2026, të Këshillit të

Ministrave “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”, sjell përgjegjësinë në përbushjen e detyrimeve ligjore dhe nevojën në praktikë për hartimin dhe miratimin e rregullave që do të garantojnë shfrytëzimin dhe rregullimin e shfrytëzimit të hapësirave publike.

Projektvendimi parashikon një rregullore të detajuar, e cila rregullon në mënyrë të posaçme përdorimin e hapësirës publike në të gjitha kategoritë kryesore të saj, duke lejuar shfrytëzimin e hapësirave publike vetëm përkundrejt pajisjes me lejen përkatëse, pas verifikimit të kriterëve të lejit të ushtrimit të secilës veprimtari, vetëm në përputhje me funksionin e hapësirës, dokumentet e planifikimit të territorit, legjislacionin sektorial dhe interesin publik.

Gjithashtu, përcakton përgjegjësitë e Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak, Policisë Bashkiake, Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe strukturave të tjera apo Drejtorive të tjera që preken nga implementimi i kësaj rregulloreje, sipas përgjegjësiave sektoriale të fushave ku ushtrojnë kompetenca, në përcaktimin, harmonizimin dhe përbushjen e detyrimeve ligjore.

Baza ligjore mbi të cilën është hartuar ky projektvendim është ligji 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe Vendimi nr. 224, datë 01.04.2026, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”.

Zbatimi i këtij akti parashikohet të jetë në harmoni me legjislacionin për mjedisin, turizmin, trashëgiminë kulturore, shëndetin publik, mbrojtjen civile, sigurinë publike, sigurinë rrugore, menaxhimin e plazheve, administrimin e bashkëpronësisë, kontrollin e punimeve të ndërtimit dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore përkatëse.

Rregullorja bashkëlidhur strukturohet në 14 krerë, si më poshtë:

KREU I - Dispozita të përgjithshme

KREU II - Strukturat zbatuese dhe monitoruese

KREU III - Shfrytëzimi i hapësirave publike për aktivitete gastronomike (bar, restorante, hoteleri dhe shërbime të ngjashme) dhe rekreative

KREU IV - Shfrytëzimi i hapësirave publike për ekspozimin e një kategorie të kufizuar mallrash jashtë njësisë së tregtimit

KREU V - Shfrytëzimi i hapësirës publike – tregje dhe aktivitete ambulatorë

KREU VI - Shfrytëzimi i disa hapësirave publike për vendosjen e stukturave të lëvizshme

KREU VII - Shfrytëzimi i hapësirave publike për vendosjen e strukturave reklamuese (struktura të tipit city light dhe tabelat reklamuese led)

KREU VIII - Shfrytëzimi i hapësirave publike – fasada për vendosjen e tabelave reklamuese

KREU IX - Shfrytëzimi i hapësirave publike për zhvillimin e panairëve dhe vendosja e veprave artistike dhe perkujtime

KREU X - Shfrytëzimi i hapësirave publike për aktivitete promovuese, artistike, kulturore, aktivitete politike e të tjera

KREU XI - Shfrytëzimi i hapësirave publike – plazhe

KREU XII - Shfrytëzimi i hapësirave publike (trotuare) gjatë ndërtimit

KREU XIII - Aktivitete të tjera në hapësira publike

KREU XIV - Dispozita të fundit

Kryetari i Bashkisë parashikohet se miraton lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike me afat deri në 1 (një) vit, ndërsa Këshilli Bashkiak miratonë lejet për shfrytëzimin e hapësirave

publike për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet. Këto leje jepen në përputhje me tarifat e miratuara.

Aplikimi për leje për shfrytëzimin e hapësirës publike kryhet nëpërmjet portalit e-Albania, ku konkretisht, do të krijohet “Regjistri Elektronik Unik” – databazë elektronike kombëtare, në të cilën regjistrohen lejet për shfrytëzimin e hapësirave publike që lëshohen nga autoritet vendore të zhvillimit të territorit.

Kjo rregullore parashikon detajimin dhe trajtimin e dhjetë tipologjive të ndryshme të shfrytëzimit të hapësirës publike, duke përcaktuar në mënyrë individuale për secilën: aktivitetet e lejuara në hapësirën publike, pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat e lejuar për t’u përdorur, masat e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat, dokumentacionin dhe procedurën e aplikimit për leje, afatin e lejes, ndalimet, mirëmbajtjen, kthimin e hapësirave publike pas përfundimit të lejes dhe masat administrative të aplikuara në vijim të shkeljeve të mundshme.

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak, në cilësinë e organit vendimmarrës, miratimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike në Bashkinë Vlorë”.

DREJTOR

Bruna Bisholla

